



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1019 Prot.

Tiranë, më datë 09.11.2020

**VENDIM**

**Nr. 381, datë 06.11.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 06.11.2020,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e relacionit mbi verifikimin në terren për varrin antik të zbuluar nga persona të pa autorizuar pranë kullës me hark në Parkun Arkeologjik të Amantias, realizuar nga DSHA dhe Drtk Vlorë-sektori i parqeve;
2. Gjetjet arkeologjike të dala si rezultat i gërmimit arkeologjik të shpëtimit të depozitohen paraprakisht në DRTK Vlorë deri në përcaktimin e destinacionit final të tyre;
3. Në përfundim të procesit gjetjet arkeologjike të regjistrohen pranë Institutit Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**Elva MARGARITI**

**SEKRETAR**

**Arta DOLLANI**